VENDIM
Nr. 555, datë 27.6.2013

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR KARAKTERISTIKAT E CILËSISË DHE KRITERET E NATYRSHMËRISË SË VAJIT TË ULLIRIT DHE VAJIT TË BËRSIVE TË ULLIRIT"[1]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6 pika 1 të ligjit nr. 87/2013, datë 25.2.2013 "Për kategorizimin e prodhimit, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit dhe vajit të bërsive të ullirit", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për karakteristikat e cilësisë dhe kriteret e natyrshmërisë të vajit të ullirit dhe vajit të bërsive të ullirit", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Kjo rregullore zbatohet për kategoritë e vajit të ullirit dhe vajit të bërsive të ullirit, të përcaktuara në nenin 5 të ligjit nr. 87/2013, datë 25.2.2013 "Për kategorizimin e prodhimit, emërtimin dhe tregtimin e vajit të ullirit dhe vajit të bërsive të ullirit".

3. Marrja e mostrave për kryerjen e analizave dhe metodat e kryerjes së analizave për përcaktimin e karakteristikave të cilësisë, kritereve të natyrshmërisë dhe të sigurisë përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për ushqimin.

4. Vendimi nr. 475, datë 10.7.2003 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores "Për karakteristikat e vajrave të ullirit"", dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

[1] CELEX 31991R2568, Rregullore e Komisionit Europian (EEC) nr. 2568/91 e datës 11 korrik 1991, e amenduar "Për karakteristikat e vajit të ullirit dhe vajit të bërsive të ullirit dhe metodat përkatëse të kryerjes së analizave".